



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 3728 Prot.

Tiranë, më 30.12.2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2782/1 PROT., DATË 30.10.2025 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. GËZIM ASLLANI"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Gëzim Asllani, me nr. 2797 prot., datë 17.10.2024 dhe nr. 2797/2 prot., datë 29.10.2024, në të cilat nuk ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të ndonjë magjistrati konkret dhe me vendimin nr. 2782/1 prot., datë 30.10.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Gëzim Asllani", bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "a", nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ka vendosur arkivimin e ankesave. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga "Irfan Tomini", pallati 22, shkalla 4, ap.43, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

